



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

*INFORMACION*

***MBI DETYRIMET E TRASHËGUARA TË KËSHILLIT TË QARKUT DHE  
AMORTIZIMIN E TYRE PËR 4/MUJORIN E PARË 2022***

Në zbatim të Ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2022”, Udhëzimit nr. 26 datë 27.09.2019 “Procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njesitë e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr. 37 date 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, Vendimit të Këshillit të Qarkut nr. 14 datë 22.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2022”, gjatë vitit 2020 dhe 2021 është punuar fort për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e stokut të borxhit, pa krijuar vështirësi financiare në financimin e shpenzimeve të periudhës aktuale. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit 2022, nuk është kryer asnjë likuidim nga detyrimet e trashëguara. Gjendja aktuale e stokut të borxhit është 469.2 mijë leke të ndara si më poshtë:

- Mallra dhe shërbime           287 mijë leke
- Te tjera                           182.2 mijë leke

Të gjitha detyrimet i takojnë periudhës para vitit 2015 në një kohë kur Institucioni ka kaluar vështirësi financiare, të trajtuara shumë herë në Këshillin e Qarkut.

Një pjesë e mirë e këtyre detyrimeve të ngelura ka mungesë dokumentacioni dhe për këtë arsye likuidimi i tyre është i vështirë.

Ne bazë të analizës të bërë në fund të periudhës 4/mujori i parë i vitit 2022, detyrimet e trashëguara gjëndje në 30.04.2022 kapin 0.41 % të totalit të shpenzimeve të planifikuara dhe Këshilli i Qarkut është në një situatë financiare normale. Institucioni ka planifikuar amortizimin e borxhit brenda Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Këshilli i Qarkut ka marrë të gjitha masat për zbatimin e këtij programi dhe mos lejimin e borxheve të krijuara rishtas.

Bashkangjitur do të gjeni të gjitha tabelat që pasqyrojnë këtë situatë.

Korçë, më 07.06.2022

Oljona Beqiraj  
Specialiste e Financës